

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Luftë" në thellësi, NATO bllokun armën sekrete ruse, do të sabotonte kabllo nënujore në Arktik
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/lufte-ne-thellesi-nato-blokon-armen-sekrete-ruse-do-te-sabotonte-kabllo-n-i585167
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 11:47:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ef34088153f22464605519ba37c4ea5aa7100b7ab52070a178769e5111cb5b31
TEKSTI	8f36233a9a9fbfcee5b5652f747fd66b762e6e4cebd24a741b30a9e9435236c6
PAMJA	6903eed1c29ac0e0a9e6ea667ff7c98ef8efe061916238191593fdc4220ca0a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cda6d6a803c4a6cafd83dc97f9c189f62cf3b8cefd8b5edf48f6339eef479a4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cda6d6a803c4a6cafd83dc97f9c189f62cf3b8cefd8b5edf48f6339eef479a4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e [GjKKQ mbyll grupin në Whatsapp të gazetareve që nuk u akredituan "Helsinki"](#) | [Ieter Burgut 31.3: Jepini fund shkeljes se të drejtave të ish-presidentit Meta!](#) | [Iopi i Artë kthehet në "çështje shteti" të fundit](#)

“Luftë” në thellësi, NATO bllokon armën sekrete ruse, do të sabotonte kabllo të nënujore në Arktik

10 Shtator 2026, 15:15 Bota TEMA



“Luftë” në thellësi, NATO bllokon armën sekrete

Në ujërat e Arktikut, pranë arkipelagut të largët të Svalbardit, këtë pranverë, aleatët e NATO-s zbuluan disa nëndetëse ruse që po stërviteshin për të përdorur një armë sekrete, të projektuar për të dëmtuar kabllo kritike nënujore pa lënë gjurmë, raporton Agjencia e lajmeve Reuters.

Operacioni i fshehtë rus, i përshkruar për Reuters nga dy zyrtarë perëndimorë, u zhvillua nga GUGI, drejtoria ruse për luftën nënujore, e cila përdori mjete zhytëse në thellësi të mëdha për të simuluar përdorimin e një teknologjie të sofistikuar dhe shkatërruese.

Një operacion i përbashkët i Britanisë së Madhe, Norvegjisë dhe Shteteve të Bashkuara gjurmoi dhe u përball me anijet ruse në det, thanë dy zyrtarët, të cilët folën në kushte anonimiteti. Anijet u penguan të përfundonin stërvitjen dhe më pas u larguan nga zona.

Britania dhe Norvegjia njoftuan në prill se kishin zbuluar një operacion të fshehtë rus në ujërat e Arktikut. Por zbulimi i armës së re, vendndodhja e operacionit dhe përfshirja e Shteteve të Bashkuara nuk ishin bërë më parë publike.

Përballja në thellësi të detit vjen në një kohë kur disa zyrtarë perëndimorë të inteligjencës druhen se Kremli po intensifikon operacionet e sabotimit në Europë dhe po përgatitet për një konflikt të mundshëm me NATO-n.

Disa analistë të inteligjencës amerikane janë gjithnjë e më të shqetësuar se Rusia mund të vërë në provë parimin e mbrojtjes së përbashkët të NATO-s, të njohur si Neni 5, thanë tre zyrtarë amerikanë. Nëse kjo ndodh, shkatërrimi i kabllove nënujore mund të jetë një pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie, thanë zyrtarët perëndimorë.

Kabllo, disa prej të cilave nuk janë më të trasha se një zorrë uji për vaditje, shtrihen në fund të detit ose janë të groposura pak nën të. Ato janë jetike për lidhjen globale të internetit dhe transaksionet financiare. Rëndësia e tyre ekonomike dhe strategjike i ka bërë objektiva edhe në konfliktet e mëparshme, përfshirë Luftën e Parë dhe Luftën e Dytë Botërore, kur ishin thelbësore për transmetimin e urdhrave përmes telegrafit dhe telefonit.

Dy kablo nënujore me fibra optike, secili rreth 1400 kilometra i gjatë, lidhin Svalbardin me Norvegjinë kontinentale dhe shtrihen deri në 2700 metra nën sipërfaqen e detit. Ato transmetojnë sasi të mëdha të të dhënave satelitore të shkarkuara në stacionin tokësor satelitor SvalSat, më i madhi në botë dhe pjesë e rrjetit të NASA-s për komunikimet pranë hapësirës.

Ministria ruse e Mbrojtjes nuk iu përgjigj kërkesës për koment lidhur me incidentin. Kremli mohon në mënyrë të vazhdueshme se kryen operacione sabotimi në vendet e NATO-s ose se po planifikon ndonjë përballje me aleancën.

Disa zyrtarë perëndimorë argumentojnë se aktivitetet ruse kundër vendeve evropiane janë shtuar muajt e fundit, ndërsa fronti në Ukrainë ka mbetur kryesisht i pandryshuar.

Polonia, Lituania dhe Rumania janë ndër vendet që kanë konfirmuar shkelje të ndryshme. Së fundmi, një përpjekje për sulm me dron ndaj aeroportit Leipzig/Halle në Gjermani, në gusht, shkaktoi një sërë reagimesh nga Berlino, përfshirë mbylljen e një konsullate ruse në Bon dhe të një qendre kulturore ruse në Berlin.

Në gusht, drejtori i CIA-s, John Ratcliffe, vizitoi homologët e tij të inteligjencës në Moskë, pjesërisht për ta paralajmëruar Rusinë kundër përshkallëzimit të operacioneve të sabotimit në Evropë, thanë dy persona të njohur me këtë çështje.

Reuters nuk mundi të përcaktonte nëse Ratcliffe ngriti gjatë takimeve edhe çështjen e operacioneve të fshehta ruse nënujore. Kremli nuk pranoi të komentojë përmbajtjen e bisedimeve apo të jepte detaje të tjera.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[25 vjet pas '11 shtatorit': A fituan në fund terroristët?](#)

13:20 Bota

[Sllovakia i del sërish kundër BE-së, bllokoi sanksionet ndaj Rusisë](#)

12:45 Bota / 1 koment

["Njerëzimi mund të zhduket deri në vitin 2030", pas alarmit nga Anthropic ligjvënësit amerikanë sulmojnë kompanitë e AI: Shumë shqetësuese](#)

12:25 Bota / 5 komente

[Prapaskena e incidentit me Zelensky-n: droni rus, alarmi dhe avioni që nuk u nis](#)

12:15 Bota

[Prapaskena! Merz akuzon AfD-në për "spastrim etnik", anulon telefonatën me Trump pasi uroi ekstremistët](#)

11:55 Bota / 4 komente

[Avionët polakë dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrainë](#)

11:15 Bota

[Irani dërgohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së: Vendimi i parë i këtij lloji në 20 vjet](#)

11:05 Bota / 1 koment

[Alarmi për klimën - Gushti 2026 regjistrohet si muaji më i nxehtë në histori, "El Niño" pritet të rrisë më tej tempe](#)

10:15 Bota

[Teherani kundërpërgjigjet ndaj SHBA-së, sulme ndaj anijeve luftarake dhe cisternave në Hormuz](#)

09:55 Bota

'Fjalim 1 orë e 45 minuta', Trump premton 5 mijë dollarë për çdo të rritur amerikan nëse fitojnë zgjedhjet e mesmandatit në nëntor

09:35 Bota / 9 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

Republika popullore e protestës

15:20 Editorial / 115 komente

"A nuk ju vjen turp?" - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...

11:53 Politika / 101 komente

Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...

14:50 Kronika / 19 komente

U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...

15:13 Politika / 73 komente

Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...

13:40 Bota / 40 komente

Blog Tema

Përse do të jetë "fair" që Erion Veliaj të lirohet

12:38 Blog / 6 komente

Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?

10:25 Blog / 19 komente

Dinjitet nuk ka vetëm deputeti...

09:42 Blog / 22 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.